



Prot. n. 100

Tirana, 5/3/2024

NJOFTIM

**DOCENTË për mësimdhënien e Gjuhës Angleze për Qendrën Universitare të Gjuhëve
pranë Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”**

Fondacioni ZKM do të punësojë **Docentë për mësimdhënien e Gjuhës Angleze** për Qendrën Universitare të Gjuhëve, pranë Universitetit Katolik ZKM. Kohëzgjatja e kontratës do të jetë 1 vit, me një angazhim *part time* duke filluar nga mars 2024.

Kandidatët duhet të zotërojnë:

- Master Shkencor ose tituj të tjerë akademikë në Gjuhën Angleze;
- Përvojë mësimdhënieje, kualifikime, kurse përditësimi dhe eksperiencë lidhur me Gjuhën Angleze;
- Aftësi komunikuese, organizuese dhe për të punuar.

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë gjithë dokumentacionin e kërkuar në adresën e-mail: personale@fzkm.org, me objekt: Pozicion pune: **Docentë për mësimdhënien e Gjuhës Angleze**, brenda datës **20 mars 2024, ora 17.00:**

1. Kërkesa drejtuar Rektorit (në anglisht);
2. *Curriculum Vitae* i firmosur (në anglisht);
3. Kopje të titujve të tjerë;
4. Kopje e një dokumenti identiteti;
5. Kopje e titullit të studimit dhe të certifikatës së notave;
6. Kopje dokumentacioni tjetër (kurse formimi, eksperiencë pune, etj);
7. Eksperiencë të tjera gjuhe të dokumentuara me certifikata, dëshmi, etj.

Nuk do të pranohen kërkesa me dokumentacion të paplotë dhe/ose jo konform me sa është kërkuar nga ky njoftim.

Përzgjedhja do të zhvillohet në vijim të komunikimit nga Zyra e Personelit të Universitetit Katolik ZKM.

Trajtimi i të dhënave personale

Të dhënat personale të kandidatëve do të mblidhen nga Fondacioni ZKM ekskluzivisht për procedurën e përzgjedhjes, duke respektuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.

Rektori
Prof. Leonardo Palombi
(firmë dhe vulë)